



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Hashim Thaçi, Isni Kilaj, Bashkim Smakaj Fadil Fazliu, dhe Hajredin Kuçi*, lidhur me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 10 dhjetor Isni Kilaj u lirua me kushte të rrepta. Në rishikimin më të fundit të paraburgimit të tij, Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me gjykimin e çështjes, konstatoi se rrethanat kishin ndryshuar që prej rishikimit të fundit të paraburgimit të z. Kilaj në tetor 2025 dhe se mbajtja e tij në paraburgim nuk ishte më e arsyeshme apo proporcionale.

Ndonëse konstatoi se vazhdonte të ekzistonte njëfarë rreziku që, nëse lirohet, z. Kilaj do të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjera, Gjykatësi arriti në përfundimin se, në rrethanat konkrete, këto rreziqe peshojnë më pak se e drejta e tij themelore për liri.

Gjykatësi mbajti parasysh, ndër faktorë të tjerë, se koha që z. Kilaj ka kaluar në paraburgim është më e gjatë se dënimi më i ulët i paraparë me ligj me të cilin ai do të dënohej nëse shpallet fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet. Gjithashtu, Gjykatësi mbajti parasysh se nuk është paraqitur asnjë provë që tregon se z. Kilaj ka tentuar të pengojë procesin gjatë periudhës së lirimit me kusht të mëparshme në vitin 2024; se paraqitja e provave në çështjen për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët* tashmë ka përfunduar; dhe se rreziku që z. Kilaj mund të ndikojë tek dëshmitarët e prokurorisë në çështjen kundër tij, duke pasur parasysh rrethanat e tyre të veçanta, është shumë i ulët.

Z. Kilaj vazhdon të jetë i akuzuar në gjykimin aktual kundër tij dhe lirimi i tij bëhet sipas disa kushteve të vendosura për të zvogëluar rrezikun që ai të ndikojë ndaj dëshmitarëve në çështjen e tij apo në çështje të tjera para Dhomave të Specializuara.

Më 4 dhjetor, Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me gjykimin e çështjes lëshoi një urdhër për caktimin e datës për fillimin e gjykimit më 24 shkurt 2026, në orën 9:30 të mëngjesit. Pas hapjes së gjykimit, Prokuroria do të paraqesë provat e saj në një bllok të vetëm dhe do të përfundojë jo më vonë se të premten, 6 mars 2026. Gjykatësi mbajti parasysh parashtrimet e palëve dhe zgjodhi datën brenda ose afër periudhës kohore gjatë së cilës të gjitha palët thanë se janë të disponueshme dhe të gatshme për fillimin e gjykimit.

Më 5 dhjetor, Paneli i Apelit rrëzoi në tërësi apelin e Fadil Fazliut kundër vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake në lidhje me mbajtjen e tij në paraburgim. Paneli i Apelit konstatoi se z. Fazliu nuk vërtetoi asnjë gabim në arsyetimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake për mbajtjen e tij në paraburgim.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykues më 10 dhjetor urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit për shkak të pranisë së rrezikut se i akuzuari mund të





pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses vuri në dukje se i akuzuari ka aftësinë për të ndërhyrë në proces; ka tentuar të dëmtojë Dhomat e Specializuara dhe u ka ofruar përfitime personave të thirrur nga Prokuroria. Trupi Gjykses rikujtoi se rreziku që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë të bëhet i ditur për publikun ekziston edhe pas dhënies së dëshmimeve prej dëshmitarëve pasi shumë dëshmitarë janë nën masa mbrojtëse dhe identitetet e tyre nuk duhet të bëhen të ditura për publikun në asnjë moment.

Sipas Trupit Gjykses, këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës për mbikëqyrjen e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstatoi se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm, Megjithatë, Trupi Gjykses theksoi se i akuzuari ka një kohë të gjatë që mbahet në paraburgim dhe se kjo kërkon që Trupi Gjykses dhe palët të tregojnë kujdes të veçantë ndaj nevojës për të siguruar që gjykimi të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në çështjen e Salih Mustafës, më 5 dhjetor Dhoma e Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht apelin e Mustafës kundër vendimit të Gjykatës të Vetëm që caktonte kamatën vjetore në 8% të shumës sipas urdhrit për zhdëmtim ndaj tij që nuk është paguar ende. Ndonëse Trupi Gjykses vuri në dukje se sipas të drejtës ndërkombëtare zakone, në përgjithësi është e mundur të caktohet kamatë në lidhje me një urdhër për zhdëmtim, për të siguruar pagesën në kohë viktimave dhe për të shmangur humbjen e vlerës, Paneli i Apelit gjykoi se mundësia e caktimit të kamatës duhej të ishte vendosur nga Trupi Gjykses. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstatoi se Gjykatësi i Vetëm veproji jashtë kornizës së kompetencave të tij kur caktoi kamatën, dhe vendosi se vendimi i tij duhet të anulohet.

